



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 4504/23
Kaçanik, 24.02.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **II (dytë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 24 shkurt 2023 (e premte). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK. Në mbledhje mungoj, Arben Thaqi- OJQ.

Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë Sali Malsiu –Drejtore i DSHMS.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e II-të (dytë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, data 24 shkurt, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Gjenda aktuale e QKMF-së,në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri.Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit ?

Procesverbalit i mbledhjes se I (parë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2023, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se I (parë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2023, të datës 17.01.2023 / Lënda : 01Nr. 60/01-1325/23.

2. Gjendja aktuale e QKMF-së, në komunën e Kaçanikut;

z.Sali Malsiu: Gjendja e QKMF-së në komunën e Kaçanikut konkretisht infrastruktura shëndetësore është në nivelin jashtëzakonisht të kënaqshëm duke u bazuar edhe në komunat që kemi përreth, këtë gjendje e kanë konstatuar dhe konfirmuar edhe të tjerët që na kanë vizituar si ish Ministri i shëndetësisë z.Rifat Latifi dhe kolegët e drejtorive nga komunat e tjera, andaj unë jam shumë i kënaqur me gjendjen e infrastrukturës shëndetësore. Një prej pengesave apo problemeve që unë shoh është renovimi dhe mirëmbajtja e objektit si dhe burimet njerëzore dhe kapaciteti i shërbimeve shëndetësore. Në fillimin e marrjes së mandatit tim si drejtor i shëndetësisë në komunën e Kaçanikut, kanë qenë të punësuar 96 punëtorë në QKMF, ndërsa tani janë mbi 110 të punësuar dhe 9 të tjerë janë në proces andaj jam i bindur që edhe ju pajtoheni që QKMF është në nivel më të qëndrueshëm dhe më të respektueshëm në nivelin lokal të komunës së Kaçanikut. Në vazhdimësi do të ju informojë lidhur me disa nga statistikat e shërbimeve që kryen brenda javës, muajit dhe vitit në QKMF.

Brenda kësaj jave të fundit janë realizuar 1489 kontrolla mjekësore dhe 861 intervenime mjekësore, të gjitha këto për një javë, ndërsa brenda një muaji janë kryer 16937 shërbime shëndetësore, prej tyre janë kryer 7678 kontrolla mjekësore, ku janë referuar për në spital 668 raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore 3003 pacient, injeksione 3468, infuzione 1760, lidhje dhe pastrim të plagëve 784, janë bërë 288 Ekg-ja, inhalime 169, janë realizuar 179 vizita shtëpiake, triazhime 169, përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet 470 që janë realizuar në QKMF, njësia e vaksinimit 578, si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike 91, në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike 1150 pacientë, në njësinë e rëntgenit kanë marrë shërbime 244 pacientë, pediatri 453 kontrolla mjekësore.

Shërbimet shëndetësore gjatë vitit 2022, Mjekësia familjare 101.890 kontrolla mjekësore, urgjenca 30.903 kontrolla mjekësore, stomatologjia 1991 kontrolla mjekësore, 1903 vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç, vaksinimi 7934, laborator 12.298, rëntgeni 4424, terreni 752, shërbime infermierike-QKMF, QMF dhe AMF 266.588 dhe totali i shërbimeve shëndetësore për vitin 2022 ka qenë 434.210.

znj.Arta Avdiu: Pse nuk vaksinohen edhe fëmijët e posalindur?

Personalisht kam pasur një rast, të cilin më është dashur ta dërgoj në Ferizaj me qëllim të marrjes së këtij shërbimi, edhe pse këtu në Kaçanik kishte material për vaksinim mirëpo mosrealizimi i kësaj konsistoi në arsyetimin se nëse nuk bëhen 7 fëmijë për këtë shërbim nuk i hapin kutit vetëm për një fëmijë. Bazuar në të gjithë këtë që potencova ju lutem na njoftoni se ku është problemi lidhur me këtë çështje?

z.Sali Malsiu: Nuk munden me hap kutin sepse i skadon dhe del jashtë përdorimit, prandaj e bëjnë me terminë deri në 7 persona.

z.Betim Shala: Orari i barnatoreve a është duke u respektuar?

z.Sali Malsiu: Një prej synimeve kur kam marrë detyrën e drejtorit të shëndetësisë ka qenë pikërisht vërja e rregullit për respektimin e orarit të barnatoreve. Andaj për këtë çështje kam realizuar dy apo tre takime deri sa kam arritur këtë qëllim timin. Orari i barnatoreve 100% respektohet, kam bërë edhe thirrje përmes rrjeteve sociale që nëse ka ndonjë rast ta paraqesin, po ashtu kam kontaktua edhe me Policinë e Kosovës dhe

kam realizuar disa takime,por fatmirësisht deri më sot nuk kanë arritur të identifikojnë asnjë rast të vetëm dhe unë jam jashtëzakonisht shumë i kënaqur me këtë rezultat.

znj.Arta Avdiu: A keni menduar edhe për ordianca stomatologjike një gjë tille?
Siç e dimë të gjithë që për një dhimbje dhëmbit, pas orës 8-të detyrohem të shkojmë në Ferizaj për ta marr këtë shërbim,pasi që në QKMF-në e Kaçanikut stomatologjia ofron shërbime vetëm ditëve të punës deri ne ora 16:00.
Andaj propozoj që me ju bë një kërkesë ordiancave stomatologjike që të ushtrojnë veprimtarin e tyre edhe mbas orës 20:00.

z.Sali Malsiu: Mundem me marr parasysh, por nuk e di sa kemi të drejt me ja imponua një gjë të tillë duke e ditur që bizneset janë private, edhe barnatoret janë private por para 10 viteve barnatoret e kanë bërë kërkesën vet dhe e kanë incuar në kuvend dhe e kanë votua dhe janë zotuar që me egzistu orari i barnatoreve.

znj.Arta Avdiu: Pse nuk e keni sjell një aparat të mamografisë dhe pse ky vit ka qenë një neglizhim,se paku një aparat me sjell për nënat,gratë dhe vajzat në komunën tonë për të kryer shërbime mamografisë.

z.Sali Malsiu: Duhet me pranua fajin tonë,realisht është dashur por ka qenë pak edhe një neglizhim i drejtorit QKMF-së,në vitin tjetër kjo çështje nuk do diskutim dhe nuk përsëritet.

z.Betim Shala: Kush i blen barnat komuna apo kush ?

z.Sali Malsiu: Listën e barnave esenciale e ka në kompetencë Ministria e Shëndetësisë, ne si komune e Kaçanikut jemi diku me përqindje të furnizum por ka komuna që prej 100% janë 30% të furnizuara dhe nuk lejohet me ligj të prokurimit mu furnizua prej listës barnave esenciale,d.m.th sistem i prokurimit cilat barna të listës esenciale nuk lejohen, këto me herët kanë furnizu por auditori ia ka gjet si të gjetur, me ç'rast as nuk lejohet me ble por as mu furnizua.


z.Ekrem Livoreka: Pse rëntgeni nuk është funksional dhe kërkesat janë për një gjinekologe që mungon në QKMF ?

z.Sali Malsiu: Për çështjen e rëntgenit e kemi procesuar një ankesë kundër operatorit sepse ai kur e ka sjell pajisjen për rëntgen e ka lan me një kod!
Sa i përket gjinekologes,dy herë është shpallur konkursi i rregullt mirëpo fatkeqësisht nuk ka aplikuar askush,gjithashtu kam marr iniciativën bashkë me zyrën prokurimit me iniciua procedurat me e realizua pagesën për specialist me qëllim që të paktën njëherë javë me qenë këtu por fatkeqësisht nuk ka pas interesim.Ne përsëri do të provojmë edhe në këtë vitë por nuk e besoj se do të realizohet sepse nuk kanë interesim.

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 11:45.

Procesmbajtësja
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka

